

MBROJTJA NGA ZJARRI

Shpëtimi i jetës dhe i pasurisë

Qytetarë të nderuar

Stina e verës sjell temperatura të larta të ajrit, të cilat e shtojnë rrezikun për shfaqjen e zjarreve në zonat malore, fushore si dhe në vendbanime. Duke pasur parasysh pasojat e katastrofave që mund të vijnë nga shpërthimet e zjarreve, përfshirë edhe jetën e njerëzve.



Apelojmë

Të jemi të kujdesshëm dhe vigjilent për shmangien e gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit. Zjarri mund të shkaktohet me një fije shkrepëse, por nuk mund të shuhet me ekipe të tëra të zjarrfikësve, përderisa pasojat mund të jenë të parashikueshme. Vëzhgimi, lajmërimi dhe alarmimi me kohë i shfaqjes së zjarrit do të mundësojë intervenimin e shpejtë dhe efikas të Shërbimeve Zjarrfikëse dhe ekipeve të shpëtimit në lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Si duhet të veprojmë në rast zjarri:

- Qëndro i qetë dhe mos bë panik!
- Thirr numrin 112 dhe lajmëro zjarrin (prezantohu, trego vendin e saktë, adresën dhe ndërlidhe atë me ndonjë objekt të rëndësishëm. Mbye linjën telefonike të lire). Nëse zjarri është në fazën fillestare provo të shuash duke përdorur batanije, shtrojë, ujë, rërë apo aparatën për fikje të zjarrit. Zjarret e shkaktuara nga rryma nuk guxojnë të shuhen me ujë. Këto zjarre shuhen me ane të aparateve për fikjen të zjarrit të mbushura me CO₂.
- Shkyçe ndërprerësin kryesorë nëse mund ti qasesh!
- Nëse zjarri përfshin rrobat e trupit atëherë mbulohu me një batanije ose shtrihu në dysheme dhe rrokullisu.
- Në rast të shfaqjes së tymit qëndro në shtëpi dhe përdorë gjëra të lagura, mbylli të gjitha të qarat - vrinat nga mund të hyj tymi në dhomë.
- Qëndro sa më poshtë që mundës, nëse është e nevojshme shtrihu në dysheme që ti ikësh tymit

- Kur të arrijnë zjarrfikësit sinjalizoi për vendndodhjen tënde.
- Gjatë gjithë kohës qëndro në linjë telefonike me numrin emergjent 112.

Informimin mund ta bëni në

- Qendrën e Alarmimit nëpërmjet numrit të integruar emergjent - **112**. Numrin emergjent **-112** mund ta thirrni dhe ta merrni pa prefix, nga çdo vend apo pozitë (tunele, puse, podrumë, humnera, kantone etj) në Republikë e Kosovës.
- Shërbimin për Zjarrfikës dhe Shpëtim mund ta merrni në numrin fiks **93**, ndërsa me telefon celular prej **VALËS 193** dhe prej telefonit celular të **IPKO-s 933**.
- Policinë e Kosovës mund ta merrni në numrin e telefonit fiks **92** dhe **192** në telefonin celular.
- Ndhimën e shpejt mjekësore mund ta merrni në numrin e telefonit fiks **94**, e celulare prej **VALËS 194** dhe **IPKO-s 944**.

Të gjitha thirrjet telefonike emergjente në numrin fiks dhe celulare janë falas.

Ligji për Mbrojtje nga Zjarri nr. 02/L-12 i obligon të gjithë qytetarët që të ndërmarrin të gjitha masat për mbrojtje nga Zjarri.